

V E N D I M
Nr. 682, datë 20.12.2002

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK PËR VITIN 2002**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e protokollit të bisedimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik, për vitin 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROTOKOLL

**I BISEDIMEVE MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK NDËRMJET QEVERISË
SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR VITIN 2002**

Në datat 18 deri 20 nëntor 2002 u zhvilluan në Tiranë bisedimet qeveritare mbi bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2002 midis delegacionit të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe delegacionit të Qeverisë së Republikës Shqiptare.

Delegacioni gjerman drejtohej nga zoti Dr. Leo Kreuz, shef seksioni në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Për delegacionin shqiptar bisedimet u drejtuan nga Zëvendësmministria e Ekonomisë, zonja Adriana Berberi.

Lista e pjesëmarrësve të dy delegacioneve ndodhet bashkëngjitur në shtojcë.

Bisedimet u zhvilluan në një atmosferë të hapur dhe konstruktive dhe u karakterizuan nga një mirëkuptim reciprok.

Kryetarja e Delegacionit Shqiptar përshëndeti miqtë gjermanë dhe i deklaroi të hapura bisedimet qeveritare.

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Në radhë të parë dëshiroj të deklaroj të hapur bisedimet ndërqeveritare për vitin 2002 dhe i uroj mirëseardhjen delegacionit gjerman. Dëshiroj, me këtë rast, që të falënderoj për ndihmën ndërshtetërore që Gjermania i ka dhënë dhe i jep vendit tonë, në kuadër të bashkëpunimit financiar dhe teknik. Po ashtu, ne vlerësojmë përpjekjet e Qeverisë Gjermane për iniciativat që ajo ka ndërmarrë dhe ndërmerr në kuadër të Paktit të Stabilitetit për sensibilizimin e shteteve ekonomikisht të zhvilluara dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare, për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe institucional të Shqipërisë, në kuadër të procesit të asociim-stabilizimit. Shqipëria vazhdon të ketë nevojë për mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe të komunitetit të donatorëve. Në sajë të ndihmës të madhe financiare nga jashtë dhe të reformave të vazhdueshme të marra nga Qeveria Shqiptare, ka stabilizuar zhvillimin e gjithanshëm të vendit. Shqipëria është e vendosur që të vazhdojë në rrugën e forcimit të kapaciteteve qeverisëse, me qëllim përgatitjen dhe implementimin për integrimin në strukturat evropiane. Struktura qeverisëse dhe institucionet janë në një proces të vazhdueshëm reformimi.

Gjermania, si donatorja kryesore në Shqipëri, ka ndihmuar dhe mbështetur procesin e gjatë të integritit të Shqipërisë në familjen evropiane, duke kontribuar dhe mbështetur sektorë të tillë të rëndësishëm të zhvillimit kombëtar. Në kuadrin e bashkëpunimit teknik midis dy qeverive tona, Qeveria Shqiptare e konsideron shoqërinë civile si një element qenësor për konsolidimin e shoqërisë

shqiptare dhe demokratizimin e kolegjalitetin e qeverisjes. Në nivele konkrete, ky bashkëpunim synon rritjen e formës së promovimit të demokracisë, decentralizimin e pushtetit lokal, dialogun, bashkëpunimin në fushën e mediave, zhvillimin e arsimit, minoritetet etj. Shqipëria duhet të angazhohet më tepër në kuadrin e përgatitjeve të saj për integrimin në Evropë. Kjo kërkon përgatitjen e strategjive në fushat e ekonomisë, përgatitjen dhe harmonizimin e legjislacionit, kryerjen e reformave në administratën publike, trajnimin në vendet e BE-së etj. Duke përfunduar, shpreh edhe një herë bindjen time më të thellë se ky bashkëpunim i frytshëm dhe konkret, si dhe fryma e ngrohtë dhe miqësore që ekziston midis dy vendeve tona do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi Shqipëria sheh te Republika Federale Gjermane mikun dhe partnerin e saj më të fuqishëm.

Kryetari i delegacionit gjerman falënderoi Zëvendësministren e Ekonomisë dhe delegacionin shqiptar për fjalët e përzemërta përshëndetëse dhe analizën e hollësishme të bashkëpunimit dypalësh. Nisur nga fakti se në vitet e fundit ka ardhur shpesh në Shqipëri me rastin e bisedimeve për bashkëpunimin dypalësh, ai shprehu bindjen se bashkëpunimi do të vazhdojë mbi këtë bazë të fortë. Njëkohësisht, kryetari i delegacionit gjerman shprehu kënaqësinë se ka gjetur te zonja Zëvendësministre një eksperte me përvojë në fushën ekonomike dhe financiare.

Duke i hedhur një vështrim traditës së gjatë të bashkëpunimit, nisur që në vitin 1988, ai nënvizoi gatishmërinë e Qeverisë Gjermane për vazhdimin e saj. Më tej, ai siguroi se Gjermania do të vazhdojë të mbështesë aktivisht Shqipërinë në procesin e përafrimit me Bashkimin Evropian nëpërmjet projekteve për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Në mënyrë që imazhi i Shqipërisë në Evropë të përmirësohet gjithnjë e më shumë, është e nevojshme që politika shqiptare të punojë më tej për mirëqenien e popullsisë. Bashkëpunimi dypalësh synon të mbështesë Shqipërinë në procesin e stabilizim-asocimit në Bashkimin Evropian. Ky proces ndikon ndjeshëm në politikën e palës shqiptare; pjesë e tij është dhe decentralizimi i mëtejshëm në vend. Në kuadër të projekteve të saj pala gjermane mbështet krijimin e kapaciteteve përkatëse të njësive të pushtetit vendor, si dhe Qeverinë Shqiptare për përshtatjen dhe thjeshtimin e procedurave administrative. Procesi i decentralizimit do të tërheqë dhe investimet private. Një shembull pozitiv është përfshirja e sektorit privat në kuadër të projektit për ujësjellësin dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Elbasan, ku është angazhuar dhe një investitor gjerman. Ky duhet të shërbejë si shembull dhe për projekte në qytete dhe sektorë të tjerë.

Bashkëpunimi dypalësh mbështetet në besimin reciprok dhe rregulla të caktuara, në mënyrë që të krijohet transparencë e nevojshme për përdorimin e mjeteve financiare. Zgjidhjet e përcaktuara gjatë këtyre bisedimeve qeveritare janë të realizueshme vetëm nëse ato zbatohen duke respektuar qëllimet e bashkëpunimit.

Në mbyllje të fjalës përshëndetëse, kryetari i delegacionit gjerman falënderoi për përgatitjen profesionale të bisedimeve, gjë që dëshmon dhe një herë se sa i gjerë dhe gjithëpërfshirës është bashkëpunimi dypalësh.

Të dyja palët përkrahin fuqimisht fushat e rëndësishme të bashkëpunimit:

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet: energjetika, reformën ekonomike/ngritja e ekonomisë së tregut, të cilat, nëpërmjet ndikimit të tyre në grupet e varfra të popullsisë, do të japin një kontribut të veçantë në politikën e luftës kundër varfërisë në kuadrin e Program-Aksionit 2015 të Qeverisë Federale Gjermane. Kryetari i delegacionit gjerman shpjegoi se në kuadër të buxhetit federal për vitin 2002 janë vënë në dispozicion mjete financiare në shumën e 15.65 milion eurove për ndihmesën e bashkëpunimit tekniko-financiar. Për këtë vit do të akordohen shumë pak mjete financiare shtesë, sikurse janë akorduar vitet e mëparshme nga fondi i Paktit të Stabilitetit, pasi ky fond pothuajse është shpenzuar krejtësisht.

Bashkëpunimi financiar (BF)

1.1. Bashkëpunimi aktual dhe aspektet themelore të tij

Në lidhje me çështje të bashkëpunimit aktual financiar, si dhe të aspekteve themelore ose të përgjithshme, u bisedua me hollësi rreth çështjeve të mëposhtme:

1.1.1. Të përgjithshme

Të dyja palët ishin dakord në lidhje me nevojën për t'i kufizuar minimalisht periudhat paraprake administrative për projektet e bashkëpunimit financiar. Në këtë kuadër pika të rëndësishme janë nënshkrimi i menjëhershëm i marrëveshjeve qeveritare, kontratave të huave dhe të financimit, si dhe paraqitja në kohë e bazës ligjore, si për shembull i vendimeve të Parlamentit ose vlerësime të Ministrisë së Drejtësisë. Në raste urgjente, si përjashtim, mund të realizohet parafinancimi i projekteve me mjete financiare nga fondi për studime dhe ekspertë.

Të dy palët diskutuan rreth propozimit të fundit të palës shqiptare lidhur me ndryshimin e procedurës së deritanishme për disbursimin e fondeve të bashkëpunimit financiar. Pala gjermane propozoi që të ruhet forma e deritanishme për këto procedura. Lidhur me këtë pala shqiptare deklaroi se përdorimi i procedurave të thesarit në procesin e disbursimit të fondeve të financuara në kuadrin e bashkëpunimit financiar jo vetëm që nuk sjell asnjë pengesë në implementimin e projektit, por është një domosdoshmëri në bazë të legjislacionit përkatës shqiptar. Këto procedura janë procedurat që përdoren për fondet e financuara në formën e kredive/granteve nga donatorë të tjerë. Gjithashtu, përdorimi i këtyre procedurave është dhe një nga kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Shqipërisë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Të dyja palët ranë dakord që të shkëmbejnë informacione për të krijuar një pamje të qartë.

Pala shqiptare siguroi nënshkrimin e menjëhershëm të kalimit formal të të drejtave dhe detyrimeve, që dalin nga kontratat e huave dhe financimit të lidhura me Bankën e Shqipërisë deri në vitin 1999, Ministrisë së Financave, si dhe njoftimin e KFW-së (Bankës për Rindërtim) për afatin e nënshkrimit.

1.1.2 Sektori i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave të zeza

Të dyja palët ishin dakord me faktin se procedura e deritanishme për transferimin e përgjegjësisë së projektit me anë kontratash mbi ndërmarrjet vendore të ujësjellësve, ishte e drejtë e për këtë arsye duhet të vazhdojë të ruhet në formën e deritanishme. Kjo praktikë duhet të vlejë dhe për projekte të ardhshme që përfshijnë sektorin privat.

Pala gjermane theksoi rishtaz rëndësinë e ecurisë së pandërprerë të procesit të decentralizimit, në mënyrë të veçantë rëndësinë e hartimit të shpejtë të dispozitave nënligjore. Lidhur me ecurinë e këtij procesi pala shqiptare deklaroi se kohët e fundit Këshilli i Ministrave miratoi politikat e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Kështu janë krijuar kushtet për kalimin e kompetencave.

Përsa i përket masave në lidhje me bisedimet/konsultimet në nivel qeveritar për çështjen e bordeve mbikëqyrëse, trajtimit të borxheve të trashëguara të ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe rregullimit të çështjes së pronësisë së sipërmarrësve të ndërmarrjeve, pala shqiptare bëri të ditur hapat e ndërmarra në periudhën e ndërmjetme dhe deklaroi se brenda vitit 2002 do të evidentohen inventari i ujësjellësve dhe do të përcaktohen organet e qeverisjes vendore, të cilave do t'u transferohen këto të drejta pronësie.

Duke marrë parasysh kuadrin e ri ligjor të krijuar në Shqipëri, mjetet financiare të parashikuara për trajnimin e stafit të Entit Rregullator të Ujit, duhet të përdoren si për Entin Rregullator, ashtu edhe për Shoqatën e Ujësllësve të Shqipërisë. Termat e referencës për mbështetjen e Entit Rregullator do të përshtaten në mënyrë të tillë që ato të reflektojnë kuadrin e ndryshuar ligjor. Ky program kualifikimi, i cili zbatohet nga Shoqata Shqiptare e Ujësllësve ka për qëllim t'u sigurojë punonjësve dhe administratave lokale kompetencën që u nevojitet për realizimin e detyrave të reja në kuadër të procesit të decentralizimit.

Pala gjermane theksoi se e konsideron si veçanërisht të rëndësishme një ent kombëtar rregullues për sektorin e ujësjellësit, në mënyrë që të sigurohen shërbimet përkatëse për furnizimin e qëndrueshëm me ujë të popullsisë. Për këtë arsye duhet që, brenda vitit 2002, të nënshkruhet kontrata për mbështetjen e Entit Rregullator duke mbajtur parasysh kuadrin ligjor përkatës.

Në mënyrë të veçantë u diskutuan projektet në zbatim e sipër në këtë sektor:

Ujësllësi Elbasan: Të dy palët janë të mendimit se zbatimi i suksesshëm i Projektit përbën një sinjal të qartë pozitiv për investitorë të tjerë potencialë në këtë sektor. është e nevojshme një punë aktive me shtypin dhe publikun si nga ana e pushtetit qendror, ashtu dhe atij vendor, në mënyrë që qytetarët të informohen mbi ecurinë në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm. Pala shqiptare konfirmoi gatishmërinë e saj për realizimin e këtij qëllimi.

Ujësllësi Berat dhe Kuçovë: Pala shqiptare garanto fillimin e menjëhershëm të hapave të nevojshëm për përgatitjen e mëtejshme të koncesionit - veçanërisht vendimet e nevojshme për përzgjedhjen e të ashtuquajturit "Transaction Adviser". Për më tepër pala shqiptare deklaroi në lidhje me këtë se, është ngritur grupi i negocimit me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, grup i cili do të marrë vendimet e nevojshme brenda vitit 2002.

Ujësllësi dhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza Kavajë: Pala gjermane vuri theksin në faktin, se nga njëra anë ky Projekt ka për qëllim përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë të pijshëm në Kavajë dhe nga ana tjetër aftësimin e strukturave përgjegjëse vendore për të menaxhuar

ndërmarrjen e ujësjellësit sipas standardeve evropiane. Për këtë arsye përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen e kontratës së menaxhimit duhet ta ketë bordi drejtues i ndërmarrjes, ku një rol të rëndësishëm luajnë autoritetet vendimmarrëse në nivel vendor. Pala shqiptare bëri të ditur se kontrata e menaxhimit do të nënshkruhet brenda tremujorit të parë të vitit 2003.

1.1.3 Sektori energjetik

Pala gjermane përshëndeti ratifikimin e "Planit shqiptar të veprimit për përmirësimin e efikasitetit teknike dhe administrative" të revizionuar rishtaz për vitin 2002-2003. Ajo bëri të ditur se në dhjetëmujorin e parë të vitit ishin përmbylur objektivat e përcaktuara në lidhje me zvogëlimin e humbjeve dhe rritjen e efikasitetit thithës janë arritur falë rezultateve të mira në tremujorin e parë.

Pala gjermane shpreson, që të mos ketë më mosrealizime objektive, si në tremujorin e tretë gjë e cila do të vinte në rrezik mbështetjen e mëtejshme në sektorin energjetik. Më tej ajo nënvizoi rëndësinë që i jep përfshirjes në të ardhmen të sektorit privat në ekonominë energjetike shqiptare si për shembull në projektet e partneritetit publiko-privat (PPP). Lidhur me këtë çështje pala shqiptare deklaroi, se ajo është duke ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përfshirë sektorin privat në këtë proces.

Në mënyrë të veçantë u diskutuan projektet aktuale në këtë sektor:

Furnizimi me energji në jug të Shqipërisë: Pala gjermane tërhoqi vëmendjen mbi faktin, se duhet të sigurohen të drejtat ujore për furnizimin e të dy hidrocentraleve Bistrica I dhe Bistrica II përpara fillimit të punimeve rehabilituese në fillim të vitit 2003. Në rast të kundërt do të ekzistonte rreziku i burimeve të pamjaftueshme ujore për prodhimin e energjisë elektrike nga të dy hidrocentralet. Qeveria shqiptare garantoj sqarimin e kësaj çështjeje deri në fund të vitit 2002.

Studim rajonal: Të dy palët u shprehën pozitivisht për ecurinë e deritanishme të studimit energjetik rajonal të bërë të njohur nga pala gjermane gjatë konsultimeve qeveritare në muajin maj. Qëllimi i këtij studimi është të sigurojë një vështrim të përgjithshëm mbi zhvillimin e ardhshëm të sektorit energjetik në Evropën Juglindore për periudhën 2002-2015 (përfshirë skemat për zhvillimin e kërkesës si dhe Leas Cost Options për zgjerimin e objekteve të prodhimit e të transmetimit). Rezultatet e studimit do t'i paraqiten për studim komunitetit të investitorëve deri në fund të vitit. Pala shqiptare theksoi, se ajo do t'i përfshinte rezultatet e këtij studimi duke i koordinuar ato me studime të tjera të realizuara ndërkohë nga organizata të ndryshme ndërkombëtare në strategjinë kombëtare për sektorin energjetik.

1.1.4 Sektori i reformës ekonomike/ndërtimi i ekonomisë së tregut

Të dy palët shprehën kënaqësinë e tyre lidhur me bashkëpunimin pozitiv në sektorin financiar për mbështetjen e biznesit më të vogël, të vogël e të mesëm. Ndërkaq është realizuar marrëveshja për administrimin e mjeteve financiare nga programi gjermano-shqiptar për mbështetjen e këtij biznesi. Meqë studimi aktual i fizibilitetit tregon se ndërkohë janë vënë në dispozicion fonde të mjaftueshme nga donatorë të tjerë për përmirësimin e situatës monetare, nuk duhet të vazhdohet më tej ky Projekt nga fondet e bashkëpunimit financiar. Krahas krijimit të mëtejshëm premtues të mikrosigurimeve po merret në konsideratë mundësia për të mbështetur biznesmenë privatë në sektorin bujqësor me fonde të bashkëpunimit financiar nëpërmjet bankës FEFAD.

1.1.5 Projekte të tjera

Aeroporti i Rinasit: Pala zbatuese e Projektit dhe firma ndërtuese kanë rënë dakord për përdorimin e pjesës së mbetur të fondeve prej 0.895 milion euro, ndërkohë mungon miratimi i nevojshëm i palës huamarrëse, Bankës së Shqipërisë. Për këtë arsye fondet janë të bllokuara. Në mënyrë që të sigurohet vazhdimi i mëtejshëm, pala shqiptare garantoj marrjen sa më të shpejtë të një vendimi.

1.2 Premtime të reja

Të dyja palët ranë dakord që me fonde të bashkëpunimit financiar për vitin 2002 në një shumë prej 12.5 milion euro të merret në konsideratë zbatimi i projekteve të mëposhtme:

1.2.1 "Mbrotjtja e liqenit të Shkodrës" 7.5 Mio euro (Kontribut financiar)

1.2.2 "Furnizimi me ujë të pijshëm/kanalizimet e ujërave të zeza

Shqipëria e Veriut (Bajram Curri)" 5.0 Mio euro (Hua)

Huaja jepet me një përqindje interesi prej 0.75% për një periudhë 40 vjeçare, shlyerja fillon pas 10 vjetësh. Meqë në parim Projekti i përmbylur kushtet për sigurimin e një kontributi financiar, në të ardhmen mund të merret në konsideratë mundësia për ta shndërruar kredinë në kontribut financiar.

1.3 Bashkëpunimi në të ardhmen

Në kuadër të fushave të përcaktuara të bashkëpunimit palët ishin dakord për ta vazhduar atë në

projektet e mëposhtme:

- Kanalizimet e ujërave të zeza në Korçë:

(Shënim: Fondet e parashikuara në një fazë fillestare për kanalizimet e ujërave të zeza u përdorën për kompletimin e Projektit aktual për furnizimin me ujë të pijshëm. Për financimin e kanalizimeve të ujërave të zeza do të jenë të nevojshme mjete financiare shtesë).

- Përsa i përket propozimeve për kanalizimet e ujërave të zeza në Rrogozhinë do të shqyrtohet mundësia e realizimit të tyre në kuadër të projektit për kanalizimet e ujërave të zeza në Kavajë ose të Projektit për ujësjellësin dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Lushnje ose në formën e një programi rajonal.

- Programi i efikasitetit energjetik për zëvendësimin e energjisë elektrike të përdorur për ngrohje nga sisteme joqendrore ngrohjeje nëpërmjet burimeve të tjera të energjisë.

- Sektori financiar/mikrosigurimet.

- Programi për luftën ndaj varfërisë.

- Heqja e mbetjeve urbane në Jug-Lindje të Shqipërisë.

- Fondi i studimeve dhe ekspertëve.

2. Bashkëpunimi teknik

Të dyja palët kanë rënë dakord në vitin 2001 për pikat e rëndësishme të bashkëpunimit bilateral për zhvillim. Edhe bashkëpunimi teknik orientohet nga këto prioritetet. Përveç kësaj ai kontribuon në kuadrin e përafrimit me Bashkimin Evropian.

2.1 Bashkëpunimi në vazhdim

Të dyja palët u shprehën të kënaqura për zbatimin e projekteve aktuale. Në veçanti u diskutuan projektet aktuale të mëposhtme:

2.1.1 Ngritja e një zyre informacioni të kredive

Projekti që financohet nga Fondi për Studime dhe Ekspertë mbështet krijimin e një zyre informacioni për kreditë, si një njësi brenda Bankës së Shqipërisë. Kjo zyrë ose regjistri i kredive siç quhet ndryshe, është një qendër që do të grumbullojë informacion nga të gjitha bankat dhe do t'i furnizojë ato me informacion për klientin duke lehtësuar procesin e vendimmarrjes në rastin e kredidhënies. Krahas këtij financimi nga Qeveria Gjermane për studime dhe asistencë teknike Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të kërkojë asistencën e institucioneve të tjera duke përfshirë këtu edhe Bankën Botërore për financimin e plotë të Projektit.

2.1.2 Mbështetja e praktikës ligjore shqiptare

Në vitin 2001 Projektit iu akorduan rreth 250 000 euro fond shtesë për financimin e një faze të mëtejshme. Për shkak të shpejtësisë së madhe të zbatimit, mund të thuhet që tani se këto fonde do të shpenzohen që në gjysmën e parë të vitit 2003. Aktualisht, Projekti mbështet ndër të tjera përgatitjen e draftit të ligjit të mbrojtjes së konsumatorit, shtesat dhe ndryshimet në ligjin mbi pronësinë industriale dhe shtesat dhe ndryshimet në ligjin mbi kartelat. Organizohen kurse kualifikimi për gjyqtarët dhe së fundi është organizuar një shkëmbim profesional ndërmjet noterëve shqiptarë dhe një dhome gjermane noterësh.

Duke marrë parasysh këto zhvillime, të dy delegacionet ranë dakord që në kuadrin e fondit të studimeve dhe ekspertëve të mbështetet më tej plotësimi i ligjeve ekonomike në funksion të përafrimit me BE.

2.2 Akordime të reja

Volumi i përgjithshëm i deritanishëm i bashkëpunimit teknik me Republikën e Shqipërisë arrin 32.3 milion euro. Për vitin 2002 Qeveria Federale i akordon Republikës së Shqipërisë një kontribut të mëtejshëm prej 3.15 milion euro për zbatimin e projekteve të bashkëpunimit teknik.

2.3 Përdorimi i fondeve

Të dy palët janë dakord për përdorimin e akordimeve të reja (pika 2.2) për projektet e mëposhtme:

2.3.1 Këshillim për përafrimin ekonomik me Bashkimin Evropian/Mbështetja e Procesit të Stabilizim Asocimit 0.75 Mio euro

2.3.2 Mbështetja e ekonomisë dhe punësimit në zonat me strukturë të dobët në veri të Shqipërisë nëpërmjet masave për reduktimin e varfërisë 1.25 Mio euro

2.3.3 Fondi i studimeve dhe ekspertëve (Fondi aktual) 0.15 Mio euro

Në këtë fond, duke përfshirë dhe akordimet e reja nuk janë shpenzuar ende 750 000 euro.

Dy delegacionet ranë dakord që të financohen masat e mëposhtme:

- Këshillim në plotësimin e disa ligjeve të përzgjedhura ekonomike në drejtim të përafrimit me BE-në.

- Mbështetja e kualifikimeve dhe e SME-ve për të papunët në rajonet e Fierit dhe Beratit.

2.3.4 Fondi i studimeve dhe ekspertëve (i ri) 1.0 Mio euro

Dy delegacionet ranë dakord që të financohen masat e mëposhtme:

- këshillim për planifikimin modern të qytetit të Tiranës;

- iniciativa e mbrojtjes së konsumatorit (Struktura publike dhe Shoqëria civile);

- këshillim paraprak në aplikimin e menaxhimit të cilësisë në ekonominë prodhuese;

- këshillim në komercializimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytete.

2.4 Bashkëpunimi i ardhshëm

Të dy delegacionet ranë dakord për të marrë në shqyrtim fushat e mëposhtme të këshillimit dhe mbështetjes për bashkëpunimin e ardhshëm:

- Modernizimi i ekonomisë bujqësore dhe ushqimore si dhe përafrimi i saj drejt Bashkimit Evropian - Shtesë fondesh.

- Forcimi i ekonomisë në rajonin e Korçës dhe Pogradecit nëpërmjet kualifikimeve profesionale.

- Fondi i studimeve dhe ekspertëve - Shtesë fondesh.

3. Format e tjera të Bashkëpunimit teknik

3.1 Ekspertët e integruar

Delegacioni gjerman theksoi se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë është e gatshme të mbështesë Republikën e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të mbuluar nevojat e saj për ekspertë në fusha të rëndësishme të politikave të zhvillimit, ku nuk ka ekspertë vendas. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë: mund të mbështesë rekrutimin e ekspertëve në tregun gjerman të punës dhe t'u sigurojë atyre në kuadrin e mundësive të saj kompensimin e pagës. Momentalisht në Shqipëri veprojnë 4 ekspertë të integruar në fushat: arsimi profesional, bujqësi, mjedis dhe media. Ndërmjetësimi i ardhshëm për ekspertë do të përqendrohet në të ardhmen në fushat për të cilat do të bien dakord dy qeveritë.

Kërkesat për ekspertët e integruar nga institucionet publike dhe private shqiptare duhet t'i drejtohen nëpërmjet Ambasadës Gjermane në Tiranë qendrës "Centrum für Internationale Migration und Entwicklung (CIM)", Barckhausstr.16, D-60325 Frankfurt am Main.

3.2 Formimi politiko-shoqëror

Delegacioni gjerman vuri në dukje se në Shqipëri veprojnë me mbështetjen financiare të Qeverisë Gjermane fondacioni Friedrich-Ebert, fondacioni Konrad Adenauer dhe fondacioni Hanns Seidel. Përveç kësaj, Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqërisë së Shkollave Popullore, zbaton masa mbështetëse për arsimimin e të rriturve.

3.3 Puna e institucioneve fetare

Kryetari i Delegacionit gjerman informoi se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë mbështet financiarisht edhe punën e institucioneve fetare gjermane në Shqipëri në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim.

3.4 Konsulencë nga shoqata "Snior Expert Service" (SES)

Pala gjermane informoi mbi veprimtarinë e SES-it të mbështetur nga Qeveria Federale Gjermane. Thelbi i këshillimit nga ekspertët në pension të kësaj organizate është zgjidhja e problemeve akute teknike dhe/ose ekonomike në firmat e vogla dhe të mesme të biznesit.

4. Kushte për zbatimin e projekteve

Të dy delegacionet ranë dakord, që të gjithë kontributet e palës gjermane të paraqitura në këtë protokoll (në pikat 1 dhe 2) mund të zbatohen vetëm pasi:

- Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë të ketë marrë një vendim pozitiv pas shqyrtimit të projekteve ose të programeve nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) (Banka për Rindërtim), Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (GTZ) (Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Teknik) dhe/ose një organizatë tjetër e ngarkuar me zbatimin e tyre;

- të jetë siguruar financimi i përgjithshëm i projekt/programit;

- të kenë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare që janë akoma në shqyrtim (marrëveshje qeveritare dhe marrëveshje projekti), si dhe kontratat e financimit, të huasë dhe të zbatimit me KfW-në, GTZ-në dhe, sipas rastit, me organizatat e tjera zbatuese.

5. Klauzolë rezervë

- Pala gjermane vuri në dukje se akordimet e bashkëpunimit financiar (pika 1) dhe të bashkëpunimit teknik (pika 2) shfuqizohen pa zëvendësim, në rast se marrëveshjet e zbatimit d.m.th. përkatësisht marrëveshjet e huasë apo të financimit për bashkëpunimin financiar dhe zakonisht shkëmbimi i notave për bashkëpunimin teknik, nuk lidhen brenda 8 viteve pas vitit të akordimit. Për akordimet e vitit 2002 afati mbaron më 31 dhjetor 2010.

- Në rast se një ose disa projekte të përmendura nuk zbatohen ose zbatohen vetëm pjesërisht, ato mund të zëvendësohen me një projekt tjetër apo me projekte të tjera, nëse të dy qeveritë bien dakord për këtë.

Deklaratë

- Pala gjermane përshëndeti masat e marra nga Qeveria Shqiptare për luftën kundër korrupsionit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria Federale Gjermane shprehën të njëjtin vlerësim se korrupsioni dëmton qeverisjen e mirë, shpërdor fondet financiare dhe ka pasoja të thella negative për zhvillimin ekonomik dhe atë social të vendit.

Ai rrezikon besueshmërinë e bashkëpunimit për zhvillim, mbështetjen e tij nga publiku dhe frenon përpjekjet e të gjithëve që angazhohen për të mbështetur zhvillimin afatgjatë, si dhe pengon konkurrencën e hapur dhe transparente, ndër të tjera lidhur edhe me çmimet dhe me cilësinë.

Të dyja qeveritë do të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën për të siguruar transparencë, dhënie llogarie dhe integritet gjatë përdorimit të fondeve publike dhe për të shmangur raste të mundshme ekzistuese të praktikave të korruptuara në bashkëpunimin për zhvillim.

Të dy delegacionet ranë dakord që konsultimet e ardhshme dhe bisedimet qeveritare 2003 të zhvillohen në Tiranë. Për afatet kohore do të bihet më vonë dakord.

Ky protokoll u hartua në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane.

Ky protokoll hyn në fuqi pas njoftimit me notë verbale të Palës Shiptare drejtuar Palës Gjermane mbi përfundimin e procedurave ligjore të miratimit të tij.

Tiranë, më 20 nëntor 2002

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës
së Shqipërisë
Adriana Berberi
Përbërja e delegacionit shqiptar

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës
Federale të Gjermanisë
Dr. Leo Kreuz

Ministria e Ekonomisë

Znj. Adriana Berberi, Zëvendësministre
Znj. Valbona Zeneli, Këshilltare
Z. Aliosha Gjondedaj, Shef i Sektorit Bilateral
Z. Gentian Beqiri, Koordinator i RFGJ-së

Ministria e Drejtësisë

Z. Alion Cenolli, Drejtor i Përafrimit të Legjislacionit

Ministria e Industrisë dhe Energjetikës

Z. Fatjon Tugu, Znj. Etleva Rustemaj

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit

Z. Arben Molla, Drejtor i Programeve Bujqësore

Ministria e Punëve të Jashtme

Z. Gazmend Turdiu, Drejtor i Drejtorisë së Vendeve
anëtare dhe pranë BE-së.

Znj. Valentina Yli, specialistë pranë kësaj Drejtorie

Ministria e Financave

Znj. Mimoza Loli, shefe e Borxhit të Jashtëm dhe
Financimeve të Huaja.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Z. Maksim Mitrojorgji, Drejtor Ekzekutiv i FSHZH

Ministria e Pushtetit Vendor dhe
Decentralizimit.

Znj. Rovenax Haxhihaxha, specialiste në Drejtorinë e
Integritetit Evropian dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Ministria e Shtetit për Integritetin

Znj. Valbona Kuko, Drejtore e Departamentit të Integritetit

Ministria e Shëndetësisë

Z. Fatmir Brahimi, Drejtor i Drejtorisë Spitalore.

Z. Agim Shehu, Drejtor i Drejtorisë së Kujdesit Parësor

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe
Turizmit

Z. Genc Gjeci, Z. Roland Olli, Z. Sadetin Limani, Z.
Bujar Rreme

Ministria e Arsimit

Z. Bashkim Muzaka

Enti Rregullator Ujërrave

Z. Vladimir Meksi

Banka e Shqipërisë

Znj. Esmeralda Uruçi

Përbërja e delegacionit gjerman

Herr Dr. Leo Kreuz	Referatsleiter 204 im Bundesministerium für wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung (BMZ)
Frau Irene Dibbern	Mitarbeiterin im Referat 204 im BMZ
Frau Sabine Bloch	Botschaftsrätin, Deutsche Botschaft Tirana
Herr Michael Dumke	Amtsrat, Deutsche Botschaft Tirana
Frau Dr. Marlis Sieburger	Abteilungsleiterin, KfW
Herr Dr. Anton Wirth	Gruppenleiter Balkan, GTZ
Herr Piro Trebicka	Lokale Fachkraft der KfW
Herr Ismail Beka	Lokale Fachkraft der GTZ
Frau Doreida Kafexhiu	Dolmetscherin